

KONTRATË BINJAKËZIMI

Përkrahje për Statistikat

Kosovë



RAPORT MBI MISIONIN

Një sistem Cilësie për Statistikat

**Faza I: Vazhdim i zhvillimit të hartës rrugore për implementimin e sistemit
te menaxhimit të cilësisë**

Komponenti 1

Misioni i realizuar nga Hilka Vihavainen & Lars Thygesen

20-23 Maj 2014

IPA 2012

Emri i autorit, adresa, e-maili

*Lars Thygesen
Statistics Denmark
Sejrøgade 11
DK-2100 Copenhagen Ø
Denmark
Tel: +4539173941
Email: lth@dst.dk*

*Hilkka Vihavainen
Statistics Finland
Verkstadsgatan 13
FI-00022 Helsinki
Finland
Tel: +358 50 5002296
Email: hilkkal.vihavainen@gmail.com*

Përmbajtja

Lista e shkurtesave	3
1. Komente të përgjithshme	4
2. Vlerësimi dhe rezultatet	4
3. Konkluzionet dhe rekomandimet	5
3.1. Rekomandim: Fuqizimi i punës së Grupit për Cilësi	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.
3.2 Rekomandim: Ndërtimi i kapaciteteve	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.
3.3. Rekomandim: Përdoruesit	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.
Puna në të ardhmen	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.
Aneksi 1. Termat e References	8
EU Twinning Project	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.
KS12 IB ST 01	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.
Komponenti 1: Nje sistem cilesie per statistikat	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.
Aktiviteti 1.0.2: Faza I: Vazhdim i zhvillimit te hartes rrugore per implementimin e sistemit te menaxhimit te cilesise	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.
Afatet kohore:.....	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.
Te R –te gatshem: 5 Maj 2014.....	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.
Fillimi /perfundimi i aktivitetit: 19-23 Maj 2014.....	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.
Raportimi: 30 Maj 2014.....	Fejl! Bogmærke er ikke defineret.
Aneksi 2. Personat e takuar	11

Lista e shkurtesave

CoP	Kodi i Praktikës
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
QAF	Korniza e Sigurimit të Cilësisë (Eurostat)
TeR	Termat e Referencës
SIDA	Agjencia Suedeze për Zhvillim Nderkombetar
SIMS	Struktura e integruar për metadata (standardi i Eurostat-it për metadata)

1. Komente të përgjithshme

Ky raport i misionit është përgatitur në kuadër të Projektit të Binjakëzimit 'Përkrahje për Statistikat'. Është misioni i katërt në komponentin 1 të projektit. Misioni kishte për qëllim të rishikojë se çfarë është arritur pas misionit të parë dhe të definojë aktivitetet e ardhshme në kuadër të komponentit. Përveç kësaj, qëllimi ishte të mbahej edhe një kurs mbi cilësinë për statisticienët dhe anëtarët e Grupit për Cilësi.

Objektivat konkrete të misionit ishin:

- Të vlerësohet gjendja e aktuale në ASK në lidhje me cilësinë
- Të rishikohet harta rrugore e aktiviteteve për të ardhmen në kuadër të komponentit 1
- Të përcillet bashkëpunimi me SIDA në lidhje me përshkrimin e statistikave dhe metadatat
- Të mbahet një kurs një ditë për stafin e ASK-së

Konsulentët dëshirojnë të falënderojnë të gjithë zyrtarët dhe personat e takuar, për mbështetjen dhe informacionet e vlefshme që kanë dhënë, gjë që ka lehtësuar shumë punën e konsulentëve dhe e kanë bërë qëndrimin në Kosovë të këndshëm dhe të paharrueshëm.

Këndvështrimet dhe vëzhgimet e paraqitura në këtë raport janë ato të konsulentëve dhe jo domosdoshmërisht përputhen me këndvështrimet e BE-së, ASK-së apo Statistikave të Danimarkës/Statistikave të Finlandës.

2. Vlerësimi dhe rezultatet

Aktiviteti u realizua në formë takimi me anëtarët e Grupit për Cilësi në ASK. U pa që ka pasur progres në organizimin e punës rreth cilësisë që nga misioni i parë. ASK-ja ka formuar Grupin për Cilësi, në përbërje prej 14 anëtarëve nga njësi të ndryshme statistikore. Gjithashtu, është emëruar menaxheri për cilësi, që ishte në Eurostat, por zyrtarja e lartë për metodologji e zëvendëson atë për momentin. Grupi për Cilësi ka vendosur të dërgojë dy anëtarë në konferencën për cilësi në Vjenë, në qershor të këtij viti. Është vendosur që përgatitja e raporteve të cilësisë të kalojë nën projektin e SIDA-s në mënyrë që të mos dyfishohen aktivitetet me projektin e binjakëzimit.

Pjesëmarrësit paraqitën problemet rreth cilësisë në fushët e tyre përkatëse. Disa pjesëmarrës theksuan që, edhe pse respektojnë standardet evropiane ose standardet e tjera ndërkombëtare në prodhimin e statistikave, ka probleme me mbledhjen e të dhënave. Mbulueshmeria e regjistrit të bizneseve nuk është sa duhet, bizneset jo domosdoshmërisht i përgjigjen pyetësorëve të ASK-së etj. Vlerësimet e përqindjes së ekonomisë joformale konsiderohen si të pasigurta. Është shënuar progres në kuptimin e bashkëpunimit me autoritetet administrative: që nga viti 2013 ASK-ja merr të dhëna nga autoritetet tatimore. Është planifikuar të bëhet krahasimi midis të dhënave nga anketat dhe të dhënave nga administrata tatimore. Qëllimet kryesore të ASK-së për prodhimin e statistikave janë rritja e konsiderueshme e numrit të indikatorëve në fusha të ndryshme statistikore dhe përmirësimi i afateve kohore. Për sa i përket indikatorëve të rinj, publikimi i llogarive kombëtare në baza tremujore në fund të vitit 2014 do të jetë një rezultat i mirë. Diskutimi rreth çështjeve ishte i hapur, gjithëpërfshirës dhe rezultoi në një pasqyrë të qartë të çështjeve, që duhet të adresohen në kuadër të këtij komponenti.

Kursi një ditë u organizua në formë dy sesionesh gjysmë dite. Qëllimi ishte të paraqitej një vështrim i përgjithshëm mbi menaxhimin e cilësisë nga perspektiva statistikore evropiane, me fokus të vecante në këto tema:

- Përkufizimi i cilësisë në statistika; parimet dhe komponentet e cilësisë
- Kodi i Praktikës i Statistikave Evropiane (CoP) dhe Korniza e Sigurimit të Cilësisë (QAF)
- Cilësia e produktit dhe procesit dhe masat për matjen e tyre
- Mjetet për matjen e perceptimeve të akterëve të ndryshëm

Ekspertët e vendeve anëtare dhanë këto prezantime gjatë misionit:

- Programi i kursit mbi cilësinë
- Përkufizimi i cilësisë në statistika
- Kodi i Praktikës
- Korniza e Sigurimit të Cilësisë (QAF)
- Cilësia e produktit dhe procesit
- Mjetet për matjen e perceptimeve të akterëve të ndryshëm
- Puna në të ardhmen
- Të mësuarit përmes internetit dhe mjetet e tjera të të mësuarit

Dy dokumente të tjera, që iu ofruan pjesëmarrësve gjatë kursit janë:

- Lista e kontrollit për sigurimin e cilësisë në anketat statistikore
- Pyetësori mbi kënaqshmërinë e përdoruesve _2010_Siloveni

Kursi u mbajt në një atmosferë të mirë. Misioni është vlerësuar shumë mirë nga pjesëmarrësit, me 4.4 nga 5 pikë të mundshme.

Në një takim të shkurtër me përfaqësuesit e SIDA-s, u bë e qartë që projekti i SIDA ka marrë përsipër asistencën në lidhje me raportet e cilësisë. Të gjitha fushat statistikore do të përshkruhen në bazë të modelit SIMS deri në fund të vitit 2015.

3. Konkluzionet dhe rekomandimet

Rekomandimet janë grupuar në tre kategori: fuqizimi i punës së grupit për cilësi, ndërtimi i kapaciteteve dhe përdoruesit.

3.1. Rekomandim: Fuqizimi i punës së grupit për cilësi

Grupi për cilësi tashmë është formuar. Është e reëndësishme që grupi të fillojë të takohet rregullisht, të përgatisë planin e punës dhe të punojë në bazë të tij. Gjithashtu, duhet të definohen procedurat e punës (cilat janë detyrat kryesore të grupit, mënyra si të përgatiten standardet, të miratohen dhe të shpërndahen tek stafi tjetër).

Plani afatshkurtër i punës duhet të përfshijë, p.sh. detyrat e mëposhtme me personat përgjegjës për to, si dhe aftet kohore perkatese:

- *Përkufizimi i deklaratës së përkushtimit për cilësi si dhe publikimi në web faqe në përputhje me Kodin e Praktikës*
- *Nje liste kontrolli e cilesise, e finalizuar dhe miratuar*
- *Realizimi dhe analizimi i rezultateve te nje hulumtimi per mangesite e mundshme dhe nevojat prioritare per trajnime*

- *Të siguruarit që përkushtimi për cilësi dhe udhëzuesit për cilësi të kuptohen dhe të ndiqen nga të gjithë në organizatë throughout the whole organization*

Eshte e nevojshme qe menaxheri i emeruar per cilesi:

- *Te mbikëqyre zbatimin e politikave dhe udhëzuesve për cilësi në tërë organizatën.*
- *Te hartojë dhe diskutojë udhëzuesit*
- *Te përcjelle punën ndërkombëtare në cilësinë në statistika dhe në këtë mënyrë te informohet rreth praktikave më të mira, që mund të përdoren si inspirim*
- *Te ushtroje detyren e sekretarit te grupit.*

3.2 Rekomandim: Ndërtimi i kapaciteteve

Sipas ASK-së, sigurimi i cilësisë për të dhënat statistikore është përgjegjësi e krerëve të produkteve statistikore. Ata zakonisht e vlerësojnë cilësinë kur produkti (p.sh. publikimi) është gati. Megjithatë, është shumë e rëndësishme që i gjithë stafi të kuptojë rëndësinë e cilësisë së produktit statistikor në të gjitha fazat e tij. Gjithashtu, është bërë e qartë se punonjësit e rinj të ASK-së në vecanti duhet të ndjekin trajnim specifik për statistikatat pasi ky lloj trajnimi nuk ofrohet në asnjë shkollë/universitet në Kosovë. Stafi i ASK-së ka nevojë për më shumë trajnime, në lidhje me çështjet e cilësisë, si dhe në përgjithësi për metodat dhe mjetet statistikore.

Perseri rekomandohet qe:

- *ASK-ja do të përpilojë draftin e programit të trajnimit për stafin. Programi i trajnimit do të përpilohet në bazë të nevojave që identifikohen në organizatë. Rekomandohet që para misionit të ardhshëm të bëhet një hulumtim për mangësitë e mundshme dhe nevojat për trajnime. Mund të bëhet në mënyrë sistematike nga ana e menaxherëve të njësisë. ASK do të rishikojë nëse gjatë viteve të ardhshme do të ketë kurse relevante evropiane (te financiarë nga programi IPA). Qellimi pastaj është të finalizohet programi i trajnimit për vitin 2015.*

3.3. Rekomandim: Përdoruesit

Publikimi në web faqe të statistikave ka rritur padyshim numrin e përdoruesve të statistikave në Kosovë krahasuar me të kaluarën. Një prej detyrave kryesore është nxitja e mëtejme e përdorimit të të dhënave statistikore. Eshtë gjithashtu e rëndësishme që përdoruesit të kuptojnë rolin e agjencisë së statistikave si ofrues i pavarur i informacioneve statistikore. Sic u diskutua edhe gjatë trajnimit, ka disa mënyra për të marrë përshtypjet e përdoruesve. Eshtë e rëndësishme të ketë takime me ta dhe t'u jepet mundësia të paraqesin kërkesat e tyre dhe mendimet lidhur me produktet statistikore dhe mangësitë eventuale. Pas marrjes së përshtypjeve të tyre, është poashtu shumë e rëndësishme që ato të analizohen dhe të nxirren përfundime për përmirësim të mëtejme.

Prandaj, përsëri rekomandohet që:

- *ASK-ja mund të përdorë ekspertët e projektit që të ndihmojnë në lidhje me seminarët me përdoruesit në fusha të ndryshme*
- *Në një periudhë afatshkurtër, mund të organizohet një forum, ku do të ftoheshin përdoruesit kryesorë, gazetarët dhe hulumtuesit.*

Puna në të ardhmen

Veprimet e nevojshme si përgatitje për misionin e ardhshëm

Veprimi	Afati kohor	Personi pergjegjes
Pergatitja e draftit te perkushtimit/politikes se cilesise	Gusht 2014	Grupi per Cilesi/ Ramizi dhe menaxheri i cilesise (Servete)
Plani i Grupit per Cilesi, i dakorduar dhe publikuar ne ASK	Sa me shpejt qe eshte e mundur	Grupi per Cilesi/ Ramizi, Ibrahimimi dhe menaxheri i cilesise
Termet e references per aktivitetin 1.2.1	Gusht 2014	RTA bashke me ASK
Ankete lidhur me mangesite e mundshme ne ASK	Gusht 2014	ASK/Ibrahimi
Programi i forumit me perdoruesit	Gusht 2014	Ekspertet bashke me ASK, Ramizin
Lista e kontrollit te cilesise, e testuar dhe miratuar	Gusht 2014	Grupi per Cilesi/ Ramizi dhe menaxheri i cilesise (Servete)

Aneksi 1. Termat e References



Projekti i Binjakëzimit i BE-se KS12 IB ST 01 Përkrahje për Statistikat

Termat e References:

Komponenti 1: Sistemi i Cilësisë për Statistikat

Aktiviteti 1.0.1: Faza I: Vazhdim i zhvillimit të hartës rrugore për implementimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë

Afatet:

TeR –data e finalizimit: 5 Maj 2014

Fillimi / fundi i aktivitetit: 19-23 Maj 2014

Koha e raportimit: 30 Maj 2014

Rezultatet obligative të komponentit:

Rezultati obligativ 1.1	Azhurnimi i planit statistikor të punës	- Standardizimi i procedurave për zhvillimin e produkteve statistikore të prezantuara deri në fund të tremujorit të 4 të projektit - Raportet e Cilësisë sipas standardeve të Eurostatit të përgatitura në 2 fusha të caktuara deri në tremujorin e 8-të të projektit	- Plani statistikor i punës - Raportet tremujore nga ana e Projektit të Binjakëzimit - Raportet e misioneve - Raportet e Cilësisë	- Përkushtimi dhe disponueshmëria në të gjitha nivelet e stafit të ASK-së dhe menaxhmentit - Komunikimi dhe pjesëmarrja efektive e të gjitha subjekteve relevante - Stafi punon në realizimin e detyrave, që lidhen me projektin, në mes misionëve - Resurse të mjaftueshme (njerëzore dhe materiale)
Rezultati obligativ 1.2	Përgatitja e politikave dhe udhëzuesve për implementimin e sistemit për cilësi	Udhëzuesi për sigurimin e cilësisë dhe dokumentimi i proceseve të produkteve statistikore, të përgatitur si draft deri në fund të tremujorit të 4 të projektit	- Raportet tremujore nga ana e Projektit të Binjakëzimit - Raportet e misionit	Komunikimi dhe pjesëmarrja efektive e të gjitha subjekteve relevante

Subjekti / qëllimi i aktivitetit: aktiviteti 1.0.2

Ky aktivitet do të jete vazhdimi i aktiviteteve të tjera në kuadër të komponentit të Cilesise.

Deri tani janë realizuar 3 misione:

- #1. Janar 2014: Zhvillimi i hartës rrugore për implementimin e një sistemi për menaxhimin e cilesise
- #2. Mars 2014: Metodologjite për zhvillimin dhe monitorimin e planit vjetor të punës për vitin 2014
- #3. Prill 2014: Prezantimi i raporteve të cilesise sipas standardeve të Eurostat-it

Ekspertët do të punojnë me tej në veprimet e propozuara gjatë misionit të parë në komponentin e Cilesise: Anketa mbi zbrazetite/mangesite në ASK, mundësitë e të mesuarit përmes internetit, dhe drafti i programit të trajnimit për cilesi.

Produkti i prituri nga aktiviteti 1.0.2:

Raporti i misionit, ku përshkruhet gjendja e tanishme në fushën e cilësisë në ASK. Harta rrugore e detajuar e aktiviteteve për pjesën e mbetur të komponentit 1. Është përgatitur një hartë rrugore në bashkëpunim me SIDA për raportet e cilësisë dhe metadat. Gjatë një takimi me SIDA do të sigurohet që kjo hartë rrugore është në përputhje me aktivitetet e ardhshme të Projektit të Binjakëzimit. Përshkrimet e statistikave të caktuara nga ASK dhe ekspertët e vendeve anëtare.

Ekipi në ASK:

Z. Ramiz Ulaj, Drejtor i Departamentit, ramiz.ulaj@rks-gov.net ASK (Udhëheqës i komponentit)
Ibrahim Rustemi, Drejtor i Departamentit të Administratës; ibrahim.rustemi@rks-gov.net
Hazbije Qeriqi, Përgjegjëse për Komunikim dhe Informim; hazbije.qeriqi@rks-gov.net
Arta Salihu, Zyrtare e Lartë për Koordinim; arta.salihu.morina@rks-gov.net
Burim Limolli, Shef i TI-se; burim.limolli@rks-gov.net
Bekim Canolli, Shef i Divizionit të Metodologjisë; bekim.canolli@rks-gov.net
Drita Sylejmani, Zyrtare e Lartë për Diseminim, drita.sylejmani@rks-gov.net

Ekspertët e vendeve anëtare:

Ms Hilka Vihavainen, Zëvendëse e Drejtorit të Përgjithshëm, Statistikat e Finlandës, hilka.vihavainen@gmail.com

Mr Lars Thygesen, Drejtor, Shitje dhe Marketing, Statistikat e Danimarkës, lt@dst.dk

Resurset e Projektit të Binjakëzimit:

Mr Per Knudsen, RTA, pkn@dst.dk

Ms Nora Zogaj, RTA asistente, nzogaj@yahoo.com

Historiku

ASK-ja përshkruan disa procedura për monitorimin e cilësinë në fazën të ndryshme të procesit të produktit statistikor, prej planifikimit dhe dizajnit të anketës deri të mbledhja, përpunimi, analizimi dhe shpërndarja e të dhënave. Rekomandimet e Eurostatit dhe praktikat më të mira më shumë përdoren si udhëzues. Zhvillimi i cilësisë dhe i trajnimeve kryesisht ofrohet nga ekspertët ndërkombëtarë

Deri tani janë realizuar 3 misione dhe ka pasur progres në punën rreth cilësisë, është formuar grupi për cilësi dhe është emëruar menaxheri i cilësisë.

Aktivitetet, që duhet të ndëmirren si parapërgatitje për misionin:

Raporti i misionit 1.0.1: Faza I: Zhvillimi i hartës rrugore për implementimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë (Vihavainen & Thygesen)

Raporti i misionit: 1.1.1 Metodologjitë për zhvillimin dhe monitorimin e planit vjetor të punës për vitin 2014 (Jurelevičenė & Gibaitė-Kudžmienė)

Raporti i misionit: 1.3.1: Prezantimi i raporteve të cilësisë sipas standardeve të Eurostat-it (Grosen në bashkëpunim me SIDA) (Ky raport do të dërgohet sa më shpejt që është e mundur)

Misioni mbi metadata me SCB dhe Binjakëzimit (dokumentni i SIDA-s)

Aktivitetet e pritura janë:

- Zhvillimi i planit të detajuar për aktivitetet e ardhshme në Cilësi në Projektin e Binjakëzimit
- Ankete mbi zbrazetite/mangësitë në ASK
- Mundësitë e të mësuarit përmes internetit
- Kursi trajnimi mbi Cilesine
- Takim dhe këshillim i Grupit për Cilësi dhe Menaxherit të Cilësise

Rezultatet e pritura:

- Raporti i misionit – sipas modelit për raportim
- Marrëveshja finale me SIDA-n lidhur me misionet në Cilësi
- Plani i detajuar për aktivitetet e ardhshme në komponentin 1 në kuadër të Projektit të Binjakëzimit

Aneksi 1. Programi - Maj 2014

Dita	Vendi	Koha	Ngjarja
1	ASK	09.00	Planifikimi i javës
		09:30	ASK: Përshkrimi i gjendjes aktuale në fushë e cilësisë në ASK si dhe perspektiva në të ardhmen
		10:30	Pushim për kafe
		11:00	Anketa mbi zbrazetite/mangësitë të ASK
		12:00	Dreka
		13:15	Vazhdim mbi anketën
		14:30	Pushim për kafe
		15:00	Takim me grupin për cilësi dhe menaxherin e cilësise
2	ASK	09:00-15:30	Kurs trajnimi mbi Cilesine
3	ASK	09:00-15:30	Vazhdim i trajnimit
4	ASK	09:00	Takime
		10:30	Pushim për kafe
		10:45	Marrëveshja për rekomandimet dhe afatin kohor
		12:00	Dreka
		15:00	Takim me udhëheqesin e projektit në ASK: rekomandimet, programi i aktiviteteve për ASK dhe plani kohor

Aneksi 2. Personat e takuar

ASK:

Ramiz Ulaj, Drejtor i Departamentit, ramiz.ulaj@rks-gov.net ASK (Udhëheqës i komponentit, Kryesues i Grupit per Cilesi)
Ibrahim Rrustemi, Drejtor i Departamentit të Administratës; ibrahim.rrustemi@rks-gov.net (anetar i Grupit per Cilesi)
Servete Muriqi, Zyrtare e Lartë në Metodologji (Menaxhere e Cilësisë në Grupin për Cilësi)
Xhevrie Fetahu, Shefe e Divizionit të Llogarive Kombëtare (anëtare e Grupit për Cilësi)
Avni Kastrati, Shef i Divizionit të Popollsisë (anetar i Grupit per Cilësi)
Ismail Sahiti, Shef i Divizionit të Statistikave Ekonomike (anëtar i Grupit per Cilësi)
Avni Zejnullahu, Divizioni i Anketave (anëtar i Grupit për Cilësi)
Besa Haqifi, ABEF, Departamenti i Statistikave Sociale
Teuta Ademi, Departamenti i Bujqësisë dhe Ambientit
Mentor Shala, Departamenti i TI dhe Metodologjisë
Arta Salihu, Zyrtare e Lartë për Koordinim
Ylli Shala, Zyrtar i Lartë në Llogaritë Kombëtare

Ekipi i projektit:

Per Knudsen, RTA
Nora Zogaj, asistente e RTA
Agim Aliu, përkthyes (në disa misione)